



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly**

**Legjislatura III
Sesioni pranveror**

Seancë plenare e Kuvendit

P- 82/26

Prishtinë, më 24 korrik 2009, në orën 15:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

P R O C E S V E R B A L

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 24 KORRIK 2009**

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 66 deputetë dhe deklaroi të hapur punimet e seancës.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-105 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009,
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik në Kosovë,
3. Shqyrtimi i propozimit të Kryesisë së Kuvendit për formimin e tri komisioneve parlamentare,

4. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për emërimin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-105 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009

Kryetari njoftoi deputetët se miratimi i këtij projektligji është bërë në seancën e djeshme plenare. Komisioni për Buxhet dhe Financa shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur Raportin me rekomandime, që u është shpërndarë deputetëve.

Kryetari ftoi kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa ose raportuesin e Komisionit, që ta marrë fjalën.

Pasi që askush nuk u paraqit për fjalë, **Kryetari** i hodhi në votim një nga një amendamentet e propozuara nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Kuvendi miratoi këto amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9.

Pastaj, Kryetari hodhi në votim Projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----69,
Kundër-----5,
Abstenime-----2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-105 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009.

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik në Kosovë

Kryetari njoftoi deputetët se komisionet parlamentare kanë shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Pasi që nuk u paraqitur askush për t'i arsyetuar rekomandimet e komisioneve parlamentare, **Kryetari** i hodhi në votim një nga një amendamentet e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Kuvendi miratoi këto amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6.

Pastaj, Kryetari hodhi në votim projektligjin në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----70,
Kundër-----2,

Abstenime-----6.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik në Kosovë.

3. Shqyrtimi i propozimit të Kryesisë së Kuvendit për formimi i tri komisioneve parlamentare

Kryetari njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e 21 korrikut 2009, ka vendosur që Kuvendit t'ia propozojë formimin e tri (3) komisioneve parlamentare, si vijon:

1. Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, nëntë (9) anëtarë,
2. Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencionit Kosovar për Inteligjencë, nëntë (9) anëtarë,
3. Komisionit për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, nëntë (9) anëtarë.

Kryetari hodhi në votim propozimin e Kryesisë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----81,
Kundër-----1,
Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

- I. Miratohet propozimi i Kryesisë së Kuvendit për formimin e tri (3) komisioneve të reja parlamentare.
- II. Komisionet nga pika një e këtij vendimi janë:
 1. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike,
 2. Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencionit Kosovar për Inteligjencë,
 3. Komisioni për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës.
- III. Përbërja e Komisioneve do të jetë me nga nëntë (9) anëtarë.

4. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për emërimin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kryetari ftoi kryetarin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi që para Kuvendit të prezantojë rekomandimin.

Bahri Hyseni tha se duke u mbështetur në normat kushtetuese Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi i ka rekomanduar Kuvendit emërimin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si në vijim: Lirije Osmani, Zhivojin Jkanoviç dhe Biljgaip Maznikar.

Pasi nuk pati të paraqitur për fjalë, **Kryetari** hodhi në votim Rekomandimin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për emërimin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----68,
Kundër-----10,
Abstenime-----4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

Për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Gjyqësor të Kosovës

- I. Anëtarë të Këshillit të Gjyqësor të Kosovës zgjedhen:
 1. Lirije Osmani,
 2. Zhivojin Jkanoviç dhe
 3. Biljgaip Maznikar.
- II. Mandati i anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës zgjat pesë (5) vjet.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kuvendit.

Seanca i përfundoi punimet në orën 15: 40 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: **Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale**